# DËSHMI ARKIVI

**A-451365**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sekuestrohen dy celularë të paligjshëm në burgje, procedohen 8 persona |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/sekuestrohen-dy-celulare-te-paligjshem-ne-burgje-procedohen-8-persona-i586619` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 08:24:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 09:00:05 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e08a9033a01ea40d87c6f7617cf1842bf65e92bb28d5b26adbe20f634e59074c` |
| TEKSTI | `443e261a79ed686ad2f9d66f3a00cc990b3208291f771961a44b9d163af218b4` |
| PAMJA | `8debde467034cb9012d46c9e3bfef013059f48dce1df0cb70c76e74422dfd7dd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ed037807f317ff59fae0ec12fa4c9edf7bb6543286bdd7af1b9eb61a740683f8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ed037807f317ff59fae0ec12fa4c9edf7bb6543286bdd7af1b9eb61a740683f8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Sekuestrohen dy celularë të paligjshëm në burgje, procedohen 8 persona

TemA
17 Shtator 2026, 11:00Kronika TEMA




Dy aparate celularë janë sekuestruar gjatë kontrolleve në IEVP Peqin dhe Fier, ndërsa një i dënuar është arrestuar në flagrancë dhe disa të burgosur e punonjës policie janë proceduar penalisht.

Kontrollet janë kryer nga Agjencia e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Në IEVP Peqin, gjatë kontrollit të sendeve personale të të burgosurit me inicialet F. Ç., është gjetur një aparat celular. Pas veprimeve të para procedurale, AMSEVP ka bërë arrestimin në flagrancë të tij për veprën penale "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale", të parashikuar nga neni 324/a/2 i Kodit Penal.

Ndërkohë, janë proceduar në gjendje të lirë edhe katër të burgosur, me inicialet M. H., L. Gj., I. L. dhe F. A., për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Për të njëjtin rast janë proceduar penalisht në gjendje të lirë edhe dy punonjës policie të IEVP Peqin, me inicialet Sh. K. dhe E. J., të dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës".

Një tjetër aparat celular është gjetur gjatë kontrollit në ambientet e dhomës së të burgosurit R. K. në IEVP Fier.

Në përfundim të veprimeve procedurale, i burgosuri R. K. është proceduar në gjendje të lirë për veprën penale "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale".

Gjithashtu, është proceduar në gjendje të lirë edhe i burgosuri E. B., për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Sipas AMSEVP, materialet procedurale do t'u dërgohen për veprime të mëtejshme Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Fier.

---

## Lini një Përgjigje

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Aksion në Korçë, 3 të rinj arrestohen duke trafikuar 6 kg drogë me makinë! Ja çfarë u sekuestrua tjetër gjatë kontrollit]

09:30 Kronika

[E rëndë në Tiranë, 12-vjeçarja abuzohet s*ksualisht nga tezja dhe kushëriri, Policia i arreston! Ja si u zbulua, në telefonin e të miturës u gjetën...]

09:20 Kronika / 5 komente

Përleshje me thika pranë shëtitores në Sarandë, tre persona mbeten të plagosur! Policia nis hetimet

08:40 Kronika / 1 koment

Arrestohet në Tiranë Eno Agaci, kushëri i biznesmenit Ergys Agaci


Arrestohet në Tiranë Eno Agasi, kushëri i biznesmenit Ergys Agasi

20:30 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.